



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM  
Nr. 63, datë 28.12.2020

**PËR MIRATIMIN E EKSPERTIT PËR VLERËSIMIN E NIVELIT TË ZOTËRIMIT  
TË GJUHËS SË HUAJ, TË DEKLARUAR NGA KANDIDATËT E LEJUAR PËR  
VENDIN VAKANT NË GJYKATËN KUSHTETUESE**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 229 dhe të pikës 5 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe të pikës 44 të vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 "Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit, dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", si dhe në mbështetje të listës së përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ekspertit për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja, të deklaruar nga kandidatët e lejuar për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese:  
- Adelina Albrahimi, përkthyesë zyrtare e licensuar nga Ministria e Drejtësisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVENDËSKRYETARE

Vitore TUSHA



ANËTARE

Miranda ANDONI

ANËTARE

Arta MARKU

ANËTARE

Fiona PAPAJORGJI

ANËTARE

Fatjona MEMÇAJ

ANËTARE

Saida DOLLANI

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2020*

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302